

ANKETA E PRODUKTEVE INDUSTRIALE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
5.1 Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit	6
9.1 Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komentet	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Vjetore të Ndërmarrjeve, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Ornela Nela
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialiste në Sektorin e Statistikave Vjetore të Ndërmarrjeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	onela@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	26.09.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	26.09.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	26.09.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Anketa e Produkteve Industriale - PRODCOM ofron informacion mbi prodhimin dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve industriale në vend në përputhje me Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi Statistikat evropiane të biznesit (Rregullorja EBS) dhe Rregulloren Zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues) Të dhënat e PRODCOM mblidhen nëpërmjet anketës vjetore të quajtur Anketa e Produkteve Industriale.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Anketa e PRODCOM bazohet në listën PRODCOM, e cila përbëhet nga rreth 4000 produkte. Lista PRODCOM ndahet në “Klasa” që korrespondojnë me klasat e Nomenklaturës së Veprimatrive Ekonomike Rev. 2 (NVE Rev.2). Brenda klasave

	individuale, titujt e listës janë vendosur në rend rritës të kodeve të tyre PRODCOM. PRODCOM përdor një kod produkti 8 - shifror të formës XX.XX.XX.YY. Katër shifrat e para të kodit korrespondojnë me klasat 4-shifrore të NVE Rev. 2. Gjashtë shifrat e para korrespondojnë me kodin 6 - shifror të Nomenklaturës së Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik (NP), e cila ofron një listim të detajuar të produkteve për çdo aktivitet ekonomik 4-shifror NVE Rev. 2. Dy shifrat e fundit ofrojnë një ndarje më të detajuar të produkteve të PRODCOM. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis klasifikimit PRODCOM dhe Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (CN). Çdo kod 8-shifror i PRODCOM mbulon një ose më shumë kode 8-shifror të CN.
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi PRODCOM mbulon të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri që operojnë në seksionin e Industrisë nxjerrëse dhe Industrisë përpunuese, seksionet B dhe C të Nomenklaturës së Veprimatrive Ekonomike (NVE Rev. 2).
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Qëllimi i këtyre statistikave është të raportohet, për çdo produkt të Listës së PRODCOM, sa produkte dhe shërbime industriale janë prodhuar në vendin raportues gjatë periudhës referuese. Kjo do të thotë që statistikën e PRODCOM lidhen me produktet (jo me aktivitetet) dhe për këtë arsye nuk janë plotësisht të krahasueshme me statistikën e bazuar në aktivitet ekonomik. Kodet NVE mbi të cilat bazohen kodet PRODCOM shërbejnë thjesht për identifikimin e ndërmarrjeve që duhet të anketohen për të mbledhur informacion mbi produktet industriale. Produktet: Lista PRODCOM përcakton produktet që përfshihen në vërtetim. Janë rreth 4000 tituj që përfaqësojnë produktet e prodhuara industriale si dhe dhe disa shërbime industriale. Sasia dhe vlera e shitjes së produkteve: Vlera shprehet në monedhën kombëtare (lekë) ndërsa sasia shprehet në njësinë matëse të specifikuar për çdo produkt. Njësitë matëse, si kilogramë, metra katrorë etj., përdoren për të treguar sasinë e produkteve të prodhuara. Variablat: Sasia e prodhuar (në njësinë matëse të përcaktuar në Listën PRODCOM) përfaqëson të gjithë prodhimin që është prodhuar nga ndërmarrja gjatë periudhës së referencës, pavarësisht nëse është shitur, magazinuar, është përdorur për përpunim të mëtejshëm apo ka qenë prodhim sipas marrëveshjeve të nënkontraktuara. Sasia e shitur e produktit (në njësinë matëse të përcaktuar në Listën PRODCOM) i referohet prodhimit bërë nga ndërmarrjet gjatë një periudhe kohore të caktuar dhe që është shitur në vitin referencë, pavarësisht nga koha e prodhimit. Këtu përfshihet prodhimin i produkteve industriale të vetë ndërmarrjes, shërbimet industriale, si dhe prodhimin e produkteve sipas marrëveshjeve të nënkontraktuara. Vlera e shitjeve i referohet shumës së faturuar nga shitja e produkteve industriale gjatë vitit referencë, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.
3.5. Njësia statistikore	Të gjitha ndërmarrjet që kanë si aktivitet prodhimin e produkteve industriale, të

	identifikuara nga regjistri i ndërmarrjeve.
3.6. Popullata statistikore	Vrojtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet industriale të cilat janë të angazhuara në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve industriale. Ndërmarrjet me më pak se 20 të punësuar anketohen duke përzgjedhur një kampion përfaqësues ndërsa ndërmarrjet me 20 ose më shumë të punësuar anketohen të gjitha.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e PRODCOM mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	PRODCOM është një vërtetim i ri dhe të dhënat e mbledhura kanë shërbyer vetëm për përdorim të brendshëm për vitet referencë 2018-2021. Për vitin referencë 2022 të dhënat janë prodhuar dhe publikuar për herë të parë në përputhje me rregulloren si dhe janë transmetuar për herë të parë në Eurostat.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Sasia: njësitë matëse janë të përcaktuara për çdo produkt në listën PRODCOM. Vlera: Të dhënat mbledhen dhe ruhen në mijë lekë, pa TVSH.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Ky raport i përket vitit referencë 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore mbi të cilën u mbështetet vërtetimi vjetor statistikor i ndërmarrjeve përbëhet nga: Në nivel kombëtar: • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Vendimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit 6 të statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor. Në nivel BE: • Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikave evropiane të biznesit

	(rregullorja EBS); • Rregullen zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues). • Rregulloren zbatuese 2022/2552 që përcakton specifikimet teknike të Listës PRODCOM.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e PRODCOM kanë filluar të transmetohen në EUROSTAT për vitin referencë 2022.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 124/2024, "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i ligjit "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendar i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (NVM) janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Rezultatet e PRODCOM publikohen në baza vjetore.
10. Akses i të dhënave dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp është publikuar online më 26 Shtator 2024 në faqen zyrtare të INSTAT: Anketa e Produkteve Industriale .
10.2. Publikime	Njoftimi për shtyp është publikuar online më 26 Shtator 2024 në faqen zyrtare të INSTAT: Anketa e Produkteve Industriale .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Baza e të dhënave nuk është publikuar akoma për PRODCOM.
10.4. Akses i të dhënave mikro	Baza e të dhënave në nivel mikro nuk është publikuar për PRODCOM.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kërkesë të Dhënash .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe

	publikimet. Informacione shitesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori në të cilin përfshihet PRODCOM dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e PRODCOM për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “ Për Statistikat zyrtare Nr.17/2018 ”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e PRODCOM krahasohen me serinë e të dhënave të PRODCOM për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Të dhënat e PRODCOM janë përdorur vetëm për përdorim të brendshëm. Publikimi i parë i PRODCOM është kryer më 28 Shtator 2023.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT organizon cdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve . Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Anketës së Produkteve Industriale është vlerësuar me 3,81 (76.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për Statistikat e Produkteve Industriale për vitin 2024 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Shkalla e Plotshmërisë të Statistikat e Produkteve Industriale për 2024 është 100 %.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet

	administrative INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë: • Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja; • Informacioni është mbledhur me intervistim ballë për ballë nga anketuesit në bazë të udhëzimeve të përgatitura për këtë qëllim; • Stafi anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen; • Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendodhjen si edhe datën dhe orën e takimit; • Prioritet i jepet bizneseve të mëdha. Kur këto ndërmarrje refuzon të përgjigjet për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT; • Kërkesë zyrtare dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni; • Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet.		
13.2. Gabim i kampionimit	Treguesit e gabimeve të kampionimit janë llogaritur për indikatorin e vlerës së shitjeve dhe pasqyrohen në Aneks. 1.		
13.3. Gabim jo i kampionimit	Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën, apo kur është e pa mundur për të gjetur informacion nga burime të tjera administrative rreth ndërmarrjes. Shkalla e mospërgjigjes për PRODCOM 2024 është 18.5%. Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli nuk gjen zbatim në rastin e PRODCOM, pasi pyetësi është i dizenuar vetëm me një tabelë. Shkalla e imputimit për PRODCOM 2024 është 12.4%.		
14. Afatet kohore dhe përpikmëria			
14.1. Afatet kohore	Të dhënat e PRODCOM për vitin referencë 2024 janë transmetuar në Eurostat në Qershor 2024. Statistikat e Produkteve Industriale janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT 269 ditë pas përfundimit të periudhës referuese. Periudha referuese e rezultateve për Statistikat e Produkteve Industriale është data 26 Shtator 2024. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024
Periudha referuese	12/31/2024		

	Data e publikimit	9/26/2025	
	Afatet kohore	269	
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Anketës së PRODCOM, janë publikuar dhe transmetuar në përputhje me afatet të përcaktuara.		
	Periudha referuese	12/31/2024	
	Data e shpallur	9/26/2025	
	Data e publikimit	9/26/2025	
	Vonesa në kohë	0	
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria			
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Nuk aplikohet.		
15.2. Krahaseshmëria kohore	Informacioni është i krahasueshëm ndër vite.		
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Bëhen kontrole të ndërthurura ndërmjet PRODCOM, ASN dhe Tregtisë së Jashtme në nivel mikro. Rastet ku hasen diferenca analizohen më tej dhe nëse është e nevojshme korrigjohen gjithashtu.		
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet.		
16. Kostoja dhe ngarkesa			
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Personat që punojnë për PRODCOM janë: • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 1 punonjës.		
17. Rishikimi i të dhënave			
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të të dhënave bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e Revizionimit; • Politika e Trajtimit të Gabimeve. Rishikimi nënkupton plotësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Saktësia e të dhënave të publikuara mund të rritet si pasojë e ndryshimeve që mundësohen nga sigurimi i të dhënave të reja më të plota dhe më cilësore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve të publikuara sipas afateve të parapërcaktuara në kalendarin e publikimeve.		
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e PRODCOM rishikohen në rastet kur: • Ka ndryshime metodologjike; • Rishikohen peshat (burime të reja dhe / ose burimeve të përmirësuara,		

	korrigjime të gabimeve). PRODCOM përpiqet të ndjekin udhëzimet standarde dhe parime në rishikimet e bëra në bashkëpunim me asistencën teknike të marrë nga eksperiencat më të mira të vendeve të bashkimit evropian. Të gjitha rishikimet janë bërë transparente për përdoruesit dhe janë pjesë e çdo botimi.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vërtetimi. Si bazë e zgjedhjes shërben regjistri i përditësuar i ndërmarrjeve, të cilat janë aktive në Shqipëri dhe operojnë në seksionin e Industrisë nxjerrëse dhe Industrisë përpunuese, perkatësisht seksionet B dhe C të Nomenklaturës së Veprimatrive Ekonomike (NVE Rev. 2). Ndërmarrjet me më pak se 20 të punësuar anketohen duke përzgjedhur një kampion përfaqësues ndërsa ndërmarrjet me 20 ose më shumë të punësuar anketohen të gjitha.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e PRODCOM për vitet referencë 2018-2021 janë mbledhur nëpërmjet intervistave ballë për ballë me pyetësorë të printuar. Të gjitha të dhënat janë të integruara në një bazë të dhënash të vetme, pasi është kryer hedhja dhe kontrolli i të dhënave. Për vitin referencë 2022 dhe në vazhdim, të dhënat e PRODCOM mbledhen nëpërmjet intervistave ballë për ballë me anë të pyetësorëve elektronikë (me laptop). Pas mbledhjes së të dhënave, stafi i IT-së vendos në dispozicion të sektorit të dhënat në formatin Excel.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Vlefshmëria e të dhënave përmban: • Kontrolle logjike brenda pyetësorit; • Krahasimi i serisë kohore (krahasimi me vitin paraardhës); • Kontrolle të ndërthurura (ASN, Tregti e Jashtë); • Krahasimi i të dhënave ndërmjet ndërmarrjeve që i përkasin të njëjtës kategori; • Krahasimi me burimet administrative si databaza e Tatimit Fitimit dhe TVSH-së.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Për përpilimin e rezultateve kemi tre procedura bazë: 1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla: • Kontrolli matematik i anketës; • Kontrolli logjik i të dhënave të anketës; • Krahasimi i të dhënave me të dhënat e viti paraardhës; • Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT; • Krahasimi i të dhënave me skedarin e Tatimit Fitimit; • Analiza e shmangie të mëdha nga mesatarja.

	2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Për ndërmarrjet që nuk përgjigjen bëhet imputim. Vlerësimi për mospërgjigjet bazohet në të dhënat e ndërmarrjes së përgjigjur në periudhën paraardhëse ose duke u bazuar në ndërmarrjet e së njëjtës natyrë. Vlerësimi bazohet në të dhënat e ASN-së ose në skedarin e Tatimit Fitimit. 3. Për pjesën e pa trajtuar përdoret metoda e ri-peshimit. Programet në SAS Software, Macro Clan përdoren për ripeshim dhe për vlerësimin e të dhënave. Vlerësimi bëhet sipas metodës tradicionale të Horvitz-Thompson (i njohur edhe si vlerësuesi π), i cili aplikohet që nga faza e dizenjimit të SRS.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga PRODCOM.
19. Komentë	
Aneks 1	

Seksioni	pTVlera2025	sTVlera2025	Koeficienti i Variacionit
B	54,726,014	969,087	1.8%
C	318,199,739	2,524,002	0.8%
E	1,302,307	-	0.0%
Total	378,895,335	3,729,391	1.0%